**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**

---

Nr. 19 Prot Shkodër, më 06 /10 /2021

**Lënda:** Kërkesë për bashkëpunim

**Drejtuar**: Z. Armando Duka, President, FSHF, Tiranë.

I nderuar Z.Duka,

Bashkia Shkodër e Këshilli Bashkiak me VKB nr. 54, datë 27.11.2020 "PËR MIRATIMIN PËR SHITJEN ME ANKAND TË AKSKONEVE TË KLUBIT TË FUTBOLLIT "VLLAZNIA" SHA NË MASEN 100% " ka miratuar shitjen 100% të aksioneve që Bashkia Shkodër zotëron si aksionere e vetme në Shoqërinë Klubi i Futbollit Vllaznia. Çmimi minimal të shitjes së 100% të kuotave është 50794 000 (pesëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katërmijë) lekë. Forma e shitjes së tyre do të bëhet nëpërmjet proçedurës konkurruese: Proçedurë e Hapur Standart e Ankandit.

Kërkojmë ndihmën tuaj lidhur me vlerësimin e specifikimeve ligjore dhe teknike për hapjen e proçedurës së hapur të ankandit për shitjen 100% të aksioneve që Bashkia Shkodër zotëron si aksionere e vetme në Shoqërinë Klubi i Futbollit Vllaznia. Ndihma juaj do të ishte e vlefshme për të përfshirë ato kritere që duhet të jenë pjesë e specifikimeve që kanë lidhje me rregulloret e FSHF-së, rregulloret e FIFA-s dhe ato të UEFA-s.

Njëkohësisht ju informojmë se Bashkia Shkodër do të vijojë me krijimin e komisionit të vlerësimit të ankandit në përbërjen e cilit propozojmë të jenë pesë anëtarë nga të cilët tre të jenë specialistë të Bashkisë Shkodër dhe dy të jenë specialistë nga FSHF.

Do t'ju falenderonim për angazhimin në këtë proçes duke mirëpritur propozimin Tuaj për anëtarët, përfaqësues të FSHF-së, në ketë komision.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA SHKODER

**KRYETAR**

**Voltana Ademi**

---

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al